

LIGJ
Nr. 92/2023
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 116/2014, “PËR AKREDITIMIN
E ORGANEVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 16, të nenit 3, shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

17. “Biobankë” është një organ që ruan mostra biologjike njerëzore dhe informacione shoqëruese të organizuara në mënyrë sistematike për qëllime kërkimore.”.

Neni 2

Në pikën 1, të nenit 5, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) organe certifikuese të personave;”

b) pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë”, “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

“ë) organe që kryejnë verifikimin dhe vlefshmërinë si aktivitet të vlerësimit të konformitetit;

f) biobanka;

g) organe të tjera që kryejnë veprimtari të vlerësimit të konformitetit.”.

Neni 3

Pas shkronjës “g”, të nenit 6, shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje: “gj) promovon rolin dhe rëndësinë e akreditimit.”.

Neni 4

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit organizohet në mënyrë të pavarur nga organet e vlerësimit të konformitetit që ajo vlerëson dhe nga ndikimet tregtare të tyre, si dhe siguron mënjanimin e konfliktit të interesave.”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon procedurat e nevojshme për të siguruar menaxhimin efikas dhe kontrollet e duhura të brendshme. Kontrollet e brendshme kryhen nga auditues vendas ose të huaj, me kompetencë në fushën e akreditimit.”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

2. Të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, sipas pikës 2, të nenit 5 të ligjit, përdoren në masën 90 për qind nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për:

- a) pagesën e vlerësuesve teknikë vendas, që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të vlerësuesve teknikë të huaj dhe të audituesve vendas ose të huaj;
- b) shpenzimet e akomodimit e të transportit të vlerësuesve teknikë dhe audituesve vendas ose të huaj;
- c) shpenzimet e trajnimeve dhe zhvillimin e vlerësuesve teknikë e të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;
- ç) promovimin e akreditimit;
- d) përmirësimin e infrastrukturës së akreditimit.”.

Neni 6

Pika 1 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ankimi kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet brenda 30 ditëve nga data kur ankimuesi ka marrë njoftim të drejtorit të Përgjithshëm të Akreditimit, i cili përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ankimit.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr.337, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET Nr. 337, datë 23.11.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 92/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 116/2014, Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë

PRESIDENT I REPUBLIKËS

SË SHQIPËRIË

Bajram Bega

